



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2505/9 prot.

Datë 12 .11.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 1655 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12 .11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1363/2025, datë 30.09.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me dreqë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Shaga” shpk, Nipt J96822229J, me adresë: *Rruga: “Hamdi Pepa”, ish Parku i Industrisë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos, me adresë: *Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

## I

### Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 30.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1363/2025, ku vendosi:

*1.Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik nga “Shaga” shpk për procedurën e prokurimit në procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*

*2.Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Shaga” shpk për procedurën e prokurimit për procedurën e prokurimit në procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*

*3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*

*4.Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.*

*5.Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shaga” Shpk .*

*6.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

*7.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 2505/6 prot., datë 10.10.2025, protokolluar me tonën nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 1363/2025, datë 30.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 2505/6 prot., datë 10.10.2025, protokolluar me tonën nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 1363/2025, datë 30.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik..

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka publikuar në sistem shtojcën për ndryshimet në dokumentat e tenderit lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 1363/2025, datë 30.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Shkolla e Magjistraturës ka zbatuar vendimin Nr. 1363/2025, datë 30.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi pasi ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) shtojcën me ndryshimet në dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e vendimit Nr. 1363/2025, datë 30.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit me prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
  2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

